

Për interesa të përbashkëta studimorë, kërkimorë dhe zhvillimorë, edukuese dhe të tjera, njësitë kryesore mund të krijojnë në bashkëpunim, qendra studimore ndërdisiplinore.

Mbi bazën e propozimeve të ardhura, nisma do të ndërmerret nga dekanati i çdo fakulteti në konsultim me njësitë bazë dhe i propozohet fakulteteve me të cilat mendohet realizimi i kësaj forme organizimi. Në këtë rast, nëse dhe fakultetet e përfshira e pranojnë në parim si propozim, ato ngrenë një grup pune të përbashkët.

Qendra studimore ndërdisiplinore ka në përbërje të saj të paktën 3 anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik. Në rastet kur kjo qendër është krijuar për interesa kërkimore, atëherë personeli akademik i punësuar duhet të ketë tituj akademikë dhe grada shkencore.

Veprimtaria e qendrës mbështetet edhe nga personeli i njësive kryesore pjesëmarrëse në bashkëpunim.

Si rregull, kjo qendër është në varësi të atij fakulteti që mbulon pjesën më të madhe të fushës kërkimore që do të realizohet nga kjo qendër, por njësitë kryesore mund të bien në marrëveshje për përcaktimin e një varësie të ndryshme të qendrës.

Hapja e qendrës studimore ndërdisiplinore, riorganizimi ose mbyllja e saj bëhen me propozim të dekanateve të njësive kryesore bashkëpunuese dhe me vendim të Senatit Akademik, pas miratimit të Bordit të Administrimit. Hapja e qendrës dhe riorganizimi i saj bëhet vetëm në fillim të vitit akademik, ndërsa mbyllja e saj mund të bëhet vetëm në përfundim të vitit akademik